

**KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT  
SH. A. PEJË**



Zyret qendrore  
Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156 30000 Pejë  
Telefoni: 039 / 432 355  
[www.hidrodrini.com](http://www.hidrodrini.com)

Në bazë të nenit 17 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 14 paragrafi 2.2 të Statutit të K.R.U. "Hidrodrini" Sh. A., Pejë, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur më datë 10.07.2026 shqyrtoi Planin e Biznesit për vitin 2026 dhe lidhur me të njëjtin, njëzëri, mori vendim për aprovimin e Planit të Biznesit.

**Vendim: Nr.19/2026**

**Plani i Biznesit 2026 i K.R.U "Hidrodrini" SH.A.,Pejë**

|                  | Delegoi                        | Aprovoi                                               |
|------------------|--------------------------------|-------------------------------------------------------|
| Emri dhe Mbiemri | Dri Cena<br>Kryeshef Ekzekutiv | Qendresa Kukaj<br>Kryesuese e Bordit të<br>Drejtorëve |
| Nënshkrimi       |                                |                                                       |
| Data             | 10.07.2026                     | 10.07.2026                                            |



# 2026

## PLANI I BIZNESIT 2026



## Tabela e përmbajtjes

|                                                                                                                 |    |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Shkurtesat – Akronimet .....                                                                                    | 3  |
| 1. Përmbledhje .....                                                                                            | 4  |
| 1.1 Të dhënat e kompanisë .....                                                                                 | 5  |
| 1.1.1 Njësitë operative të ujësjellësit – NJO Qendrore .....                                                    | 7  |
| 1.1.2 Njësitë operative të ujësjellësit – NJO Istog .....                                                       | 9  |
| 1.1.3 Njësitë operative të ujësjellësit – NJO Klinë .....                                                       | 10 |
| 1.1.4 Njësitë operative të ujësjellësit – NJO Deçan .....                                                       | 12 |
| 1.1.5 Njësitë operative të ujësjellësit – NJO Junik .....                                                       | 13 |
| 2. Metodologjia e përpilimit të Planit të Biznesit 2026.....                                                    | 15 |
| 2.1 Baza ligjore me ndikim të drejtpërdrejtë në ndërmarrje .....                                                | 15 |
| 3. Deklarata e KRU “Hidrodrini” SH.A.....                                                                       | 16 |
| 3.1 Deklarata e Misionit.....                                                                                   | 16 |
| 3.2 Deklarata e Vizionit .....                                                                                  | 16 |
| 4. Qëllimi dhe objektivat strategjike të KRU “Hidrodrini” Sh.A. – periudha 2026-2028                            | 16 |
| 4.1 Vlerësimi i performancës në vitin paraprak (2025) dhe planifikimi 2026.....                                 | 18 |
| 5. Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitet paraprake dhe planifikimi për 2026..... | 19 |
| 6. Burimet ujore, infrastruktura dhe tarifat e shërbimit.....                                                   | 19 |
| 6.1 Impiantet e ujit të pijes dhe trajtimi të ujërave të ndotura .....                                          | 22 |
| 6.1.1 Impianti i Trajtit të Ujit për Pije (ITUP) dhe Fundërruesi (para filtrimi) - Klinë .....                  | 22 |
| 6.1.2 Impianti për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN) - Pejë .....                                           | 24 |
| 6.1.3 Trajtimi i ujërave të ndotura komunale në ITUN Peja.....                                                  | 25 |
| 6.1.4 Aspektet operationale.....                                                                                | 26 |
| 6.2 Tarifat e shërbimit.....                                                                                    | 26 |
| 7. Departamenti teknik.....                                                                                     | 30 |
| 7.1 Organizimi i Departamentit Teknik.....                                                                      | 30 |
| 7.2 Sektori i GIS.....                                                                                          | 33 |
| Departamenti i kualitetit të ujit .....                                                                         | 35 |
| 8. 35                                                                                                           |    |
| Departamenti Komercial .....                                                                                    | 36 |
| 9. 36                                                                                                           |    |
| 9.1 Faturimi .....                                                                                              | 37 |
| 9.2 Arkëtimi dhe inkasimi .....                                                                                 | 37 |
| 9.3 Arkat .....                                                                                                 | 38 |
| 10. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit.....                                                           | 38 |
| 11. Departamenti Financiar .....                                                                                | 40 |
| 11.1 Pagesa e shpenzimeve .....                                                                                 | 40 |
| 11.2 Siguria financiare .....                                                                                   | 40 |
| 11.3 Kontingjentet dhe detyrimet.....                                                                           | 40 |

|                |                                                                                                                                    |    |
|----------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 11.4           | Buxheti vjetor për vitin 2026.....                                                                                                 | 41 |
| 12.            | Investimet Kapitale në KRU “Hidrodrini” Sh.A. ....                                                                                 | 44 |
| 12.1           | Shpenzimet për furnizim dhe shërbime .....                                                                                         | 44 |
| 12.2           | Projektet e propozuara nga KRUH për financim nga Ministria e Ekonomisë për vitin 2026                                              | 46 |
| Shtojca 1      | .....                                                                                                                              | 49 |
| Shtojca 2      | .....                                                                                                                              | 50 |
|                |                                                                                                                                    |    |
| Fotografia 1.  | Harta e zonës së shërbimit të KRU “Hidrodrini” SH.A. ....                                                                          | 6  |
| Fotografia 2.  | Harta e zonës së shërbimit të KRU “Hidrodrini” SH.A. – Komuna e Pejës .....                                                        | 8  |
| Fotografia 3.  | Harta e zonës së shërbimit të KRU”HIDRODRINI” SH.A - Komuna e Istogut .....                                                        | 10 |
| Fotografia 4.  | Harta e zonës së shërbimit të KRU”HIDRODRINI” SH.A - Komuna e Klinës .....                                                         | 11 |
| Fotografia 5.  | Harta e zonës së shërbimit të KRU”HIDRODRINI” SH.A - Komuna e Deçanit .....                                                        | 13 |
| Fotografia 6.  | Harta e zonës së shërbimit të KRU “HIDRODRINI” SH.A. - Komuna e Junikut.....                                                       | 14 |
| Fotografia 7.  | Zona e shërbimit të KRU “Hidrodrini” Sh.A. – Burimet e ujit.....                                                                   | 19 |
| Fotografia 8.  | Zona e shërbimit të KRU “Hidrodrini” Sh.A. – Burimet e ujit 2 .....                                                                | 21 |
| Fotografia 9.  | Rrjeti i kanalizimit i ndarë në bazë të kolektorëve .....                                                                          | 22 |
| Fotografia 10. | Pamje e ITUP në Klinë.....                                                                                                         | 23 |
| Fotografia 11. | Pamje e brendshme e ITUP në Klinë .....                                                                                            | 23 |
| Fotografia 12. | Fundërruesi .....                                                                                                                  | 24 |
| Fotografia 13. | Pamje nga lartë e ITUN në Pejë .....                                                                                               | 25 |
| Fotografia 14. | Pamje nga lartë i ITUN në Pejë - 2.....                                                                                            | 26 |
| Fotografia 15. | Rrjeti i ujësjellësit sipas diametrit në të gjithë zonën e shërbimit të KRUH .....                                                 | 32 |
| Fotografia 16. | Rrjeti i kanalizimit në të gjithë zonën e shërbimit të KRUH.....                                                                   | 33 |
|                |                                                                                                                                    |    |
| Tabela 1.      | Prodhimi, faturimi, humbjet, shpenzimet dhe inkasimi 2023-2026 .....                                                               | 19 |
| Tabela 2.      | Burimet e ujit .....                                                                                                               | 20 |
| Tabela 3.      | Tarifat volumetrike për aktivitetet themelore të ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura për vitin 2026 ..... | 27 |
| Tabela 4.      | Tarifa fikse mujore.....                                                                                                           | 27 |
| Tabela 5.      | Tarifa për inspektimin e lidhjes së re në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit .....                                             | 27 |
| Tabela 6.      | Tarifat për realizimin fizik të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit .....                                                            | 28 |
| Tabela 7.      | Tarifat për realizimin fizik të lidhjes në rrjetin e kanalizimit .....                                                             | 28 |
| Tabela 8.      | Tarifa për ndërprerjen e përkohshme të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit .....                                                     | 29 |
| Tabela 9.      | Tarifa për ndërprerjen e përhershme të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit.....                                                      | 29 |
| Tabela 10.     | Tarifa për ri-lidhje në rrjetin e ujësjellësit (pas ndërprerjes së përkohshme) .....                                               | 29 |
| Tabela 11.     | Testimi i ujëmatësit për siguri të matjes .....                                                                                    | 29 |
| Tabela 12.     | Tarifa e mbi-ngarkesës (përforcimit) së infrastrukturës.....                                                                       | 29 |
| Tabela 13.     | Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit sipas njësive në KRUH.....                                                                      | 34 |
| Tabela 14.     | Asetet jo-infrastrukturore të KRUH .....                                                                                           | 34 |
| Tabela 15.     | Gjatësia e rrjetit të kanalizimit sipas njësive në KRUH.....                                                                       | 34 |
| Tabela 16.     | Planifikimi buxhetor për vitin 2026 - Performanca janar-qershor .....                                                              | 41 |

|                                                                                          |           |
|------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <i>Tabela 17. Planifikimi buxhetor për vitin 2026 – Performanca korrik-dhjetor .....</i> | <i>42</i> |
| <i>Tabela 18. Planifimi buxheti për vitin 2026 – Raporti FaturimiëInkasim .....</i>      | <i>42</i> |
| <i>Tabela 19. Planifimi buxhetor për vitin 2026 – Shpenzimet .....</i>                   | <i>42</i> |
| <i>Tabela 20. Caqet 2026-2028 .....</i>                                                  | <i>43</i> |
| <i>Tabela 21. Shpenzimet për furnizim për vitin 2026.....</i>                            | <i>44</i> |
| <i>Tabela 22. Shpenzimet për shërbime për vitin 2026.....</i>                            | <i>45</i> |
| <i>Tabela 23. Shpenzimet për punë për vitin 2026.....</i>                                | <i>45</i> |
| <i>Tabela 24. Rikapitulimi i shpenzimeve për vitin 2026 .....</i>                        | <i>45</i> |

## Shkurtesat – Akronimet

ARRU - Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit

ASK - Agjensioni i Statistikave të Kosovës

BPRR - Biznes Planet Rregullatorë

BRRA - Baza Rregullatore e Aseteve

BD - Bordi i Drejtorëve

IKSHPK - Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës

IÇKK - Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë

KNMU - Këshillit Ndërmnistror për Ujëra

KRU - Kompania Rajonale e Ujësjellësit

KRUH – Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidrodrini”

NJPMNP - Njësia për Politika e Monitorim të Ndërmarrjeve Publike

QU - Qendra e Ujit

UPF - Uji i pa-faturuar

UA - Udhëzimi Administrativ

OSH - Ofruesit e Shërbimeve

SIG - Sistemi Informativ Gjeografik (GIS)

TKP - Treguesit Kyç të Përformancës

GNI - Grupi Ndërinstitucional

SHUKOS - Shoqata e Ujësjellësve dhe Kanalizimit të Kosovës

NJO - Njësia Operative

BV - Biznese të Vogla

BM - Biznese të Mëdha

ITUP - Impiant i Trajtimit të Ujit të Pijes

ITUN – Impianti i Trajtimit të Ujit të Ndotur

DMA - District meter area (Zona të matura)

## 1. Përmbledhje

Plani i Biznesit përshkruan qëllimet, strategjitë dhe aktivitetet e propozuara të kompanisë, që planifikohen të ndërmerren dhe synohen të arrihen gjatë vitit 2026 duke përfshirë edhe planet dhe detajet e veprimeve të cilat do të ndërmerren gjatë vitit 2026. Prandaj, konsiderohet se ky plan do të shërbejë si udhërrëfyes në realizimin e caqeve të kompanisë, si dhe në monitorimin e përmbushjes së tyre.

Hartimi i Planit të Biznesit është obligim për Kompaninë i dalë nga Ligji për Ndërmarrjet Publike e që në fund i dërgohet Ministrisë së Ekonomisë si dokument informativ, këtë dokument në aspektin strategjik dhe operacional e ka për obligim ta hartojë Menaxhmenti i Kompanisë, i mbështetur dhe i mbikëqyrur nga Bordi i Drejtorëve.

Ky dokument është punuar duke u mbështetur në gjendjen aktuale dhe duke u mbështetur në trendet e zhvillimit të këtij sektori në vend dhe në regjion, duke adoptuar praktikat pozitive nga kompanitë e ndryshme me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara nga menaxhmenti.

Për vitin e ardhshëm 2026, planifikimet kryesore janë që të zgjerohet zona e mbulimit me shërbime të ujit dhe kanalizimit, ku synimet janë që të ketë furnizim me ujë të pijes në mbi 99% si dhe të rritet mbulueshmëria me Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura për qytetin e Pejës.

Objekti bazë do të jetë zvogëlimi i humbjeve të ujit, që është problem kapital për Kompaninë andaj përpjekjet do të jenë maksimale për të eliminuar humbjet e ujit, që mendohet të bëhen përmes: bashkëpunimit Inxhinier – Inspektor në ç'kyçjen e borxhlinjve, caktimi i zonave DMA, si dhe kontrolli i zonave shtëpi për shtëpi të kyçjeve ilegale, si dhe instalimin e ujëmatësve të mençur të cilët ndërpresin ujin në mënyrë automatike, trajnime të ndryshme për punëtorët e ujësjellësit, menaxhimi i presionit të ujit, duke instaluar frekuentor si dhe Skada sisteme gjë që ndihmojnë në kontrollin e presionit të ujit dhe parandalon prishjen e rrjetit të ujësjellësit, vazhdimi i punës për identifikimin e shfrytëzuesve të pa autorizuar (keqpërdorimet), rritjen e investimeve në zëvendësimin e gypave të vjetruar etj.

Faturimi do të jetë i rregullt tek të gjithë konsumatorët e regjistruar, çdo muaj, duke u bazuar kryesisht në konsumin e lexuar. Synimi i kompanisë gjatë vitit 2026 do të jetë ngritja e normës së faturimit deri 98%.

Të hyrat dhe shpenzimet e Kompanisë për vitin 2026 janë analizuar në mënyrë të decentralizuar, nga poshtë – lartë (Njësi Operative – Menaxhment) dhe si përfundim planifikimi ynë është që deri në fund të vitit 2026 të arkëtojmë deri në **6,340,208.51 euro**, të cilat konsiderohet se janë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve operative dhe nevojave investive për këtë periudhë planifikuese.

Me mundësinë e re të inkasimit përmes formave online, kontratat me konsumatorë përmes bankave dhe me aksione të inspektoratit pasqyruar edhe përmes mediave ndaj borxhlinjëve të këqij, do të bëhen përpjekje maksimale që llogaritë e arkëtueshme të shndërrohen në inkasim – arkëtim. Po ashtu, në vitin 2026 do të përpilojmë edhe Rregulloren për Llogari të Arkëtueshme, si dhe do të provizionojmë ato.

Sa i përket resurseve humane, boshllëqet që janë në kompani do të plotësohen, duke mos lënë anash edhe trajnimet dhe specializimet e ndryshme të nevojshme për të arritur objektivat që kemi vendosur si kompani.

## 1.1 Të dhënat e kompanisë

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) në bazë të marrëveshjes së përbashkët me pesë komunat (Pejë, Deçan, Istog, Klinë dhe Junik) në Tetor të vitit 2004 ka themeluar Kompaninë Rajonale për Ujë dhe Kanalizim “Hidrodrini”.

Kjo kompani funksionon si shoqëri aksionare është e organizuar sipas rregullit ekzistues të ligjeve të Kosovës dhe në përputhje me ligjin në fuqi mbi shoqëritë tregtare dhe nga data 31.05.2007, KRU “Hidrodrini” Sh. A, nga Qeveria e Kosovës gjegjësisht nga ish - Ministria e Zhvillimit Ekonomik është pajtuar të zhvilloj aktivitetin me numër të ri të biznesit 70432209.

Sipas Ligjit Nr.03ëL-087 për Ndërmarrjet Publike, kompania funksionon si Ndërmarrje Publike Qendrore nën mandatin e Ministrisë së Ekonomisë të Republikës të Kosovës



KRU “Hidrodrini” Sh.A. është institucion publik profesional i licencuar nga Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit, për ofrimin e shërbimeve bazë, të furnizimit me ujë të pijshëm dhe për shërbime të kanalizimit për banorët e pesë komunave të regjionit të Pejës.

Numri popullatës që KRU “HIDRODRINI” ofron shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm për një popullsi që vlerësohet të jetë rreth 186.000 banorë dhe shërbime të trajtimit të ujërave të zeza për rreth 77.000 banorë. Kapaciteti momental prodhues sillet afërsisht rreth 47,733,713.02 m<sup>3</sup>ëvit. Me vendosjen e ujëmatësve që janë bërë në burime, ka të dhëna të sakta të kapaciteteve prodhuese të ujit.

Kompania është dhe do të mbetet ofrues profesional i furnizimit me ujë të pijshëm të cilësisë së lartë dhe të shërbimeve të kanalizimit. Prodhimi dhe shitja e ujit, si dhe shërbimet e kanalizimit janë detyrat kryesore të kompanisë. Qendra e kompanisë është në Pejë. Në strukturën e vet, kompania ka pesë njësi operative: Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Deçan.

Bordi i Drejtorëve është organ i pavarur dhe bënë mbikëqyrjen e biznesit të kompanisë. Personeli menaxhues i kompanisë organizon punën dhe kryen udhëheqjen efektive të veprimtarisë.

Në kuadër të furnizimit apo të prodhimit të ujit të pijshëm, Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidrodrini” ka këto të dhëna për njësitë operative: Qendrorja, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik.



Fotografia 1. Harta e zonës së shërbimit të KRU “Hidrodrini” SH.A.



### 1.1.1 Njësitë operative të ujësjellësit – NJO Qendrore

Kjo njësi furnizon me ujë të pijes qytetin e Pejës dhe 49 fshatra përreth. Gjithë furnizimi me ujë të pijes bëhet nga dy burime kryesore: Burimi i Drinit të Bardhë dhe Burimi i Ujit të Zi, si dhe nga dy burime më të vogla: Burimi i Ujit të Bardhë dhe ai i Raushiqit. Nga burimi i Drinit të Bardhë i gjithë sistemi operon me gravitet, ku nga kjo pjesë furnizohet me ujë një pjesë e qytetit të Pejës, Lugu i Trestenikut dhe Lugu i Leshanit.

Nga burimi Uji i Zi, uji rrjedhë me gravitacion deri tek objekti i kompanisë ku pastaj ndahen tri sisteme:

1. Sistemi i gravitetit që furnizon një pjesë të qytetit të Pejës;
2. Sistemi i pompave shtytëse që po ashtu e furnizon një pjesë të qytetit të Pejës dhe vazhdon deri në fshatin Bellopojë.
3. Sistemi i pompave të reja që shtynë ujin në rezervuarin 3000 m<sup>3</sup> dhe nga i cili furnizohen me ujë pjesët më të larta të qytetit të Pejës.

Njësia Operative Pejë ka dy stacione kryesore të pompimit dhe 18 stacione tjera ndihmëse. Me dy depo të ujit të pijshëm me rreth 1500 m<sup>3</sup> dhe 3000 m<sup>3</sup>, 467km' rrjet i ujit me tubacione të profileve të ndryshme, dy stacione të klorinimit, 211km' rrjet i kanalizimit dhe Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura me kapacitet për 81.000 banorë.




Fotografia 2. Harta e zonës së shërbimit të KRU “Hidrodrini” SH.A. – Komuna e Pejës


## 1.1.2 Njësitë operative të ujësjellësit – NJO Istog

Burimet kryesore që furnizojnë komunën e Istogut dhe fshatrat përreth janë:

1. Burimi i Istogut,
2. Burimi i Vrellës dhe
3. Burimi i Kosharishtes dhe Vojdullit.

Kjo Njësi Operative furnizon me ujë të pijes qytetin e Istogut dhe 46 fshatra përreth. Posedon 8 depo (rezervuare) të ujit me kapacitet 700 m<sup>3</sup>, 400 m<sup>3</sup>, 400 m<sup>3</sup>, 800 m<sup>3</sup>, 500 m<sup>3</sup>, 200 m<sup>3</sup>, 400 m<sup>3</sup>, 400 m<sup>3</sup>, 7 stacione të pompimit dhe 5 stacione të klorinimit.







Fotografia 3. Harta e zonës së shërbimit të KRU "HIDRODRINI" SH.A - Komuna e Istogut

### 1.1.3 Njësitë operative të ujësjellësit – NJO Klinë


Burimi i ujit Jarinë furnizon me ujë qytetin e Klinës dhe disa fshatra. Fabrika ka një kapacitet prodhues prej 310 m<sup>3</sup>ëorë (86.1 lës), por meqenëse uji që vjen nga pusët është në një sasi më të vogël dhe uji i basenit të hapur është me turbullirë të lartë. Prodhimi i ujit varet nga turbullirat e ujit të lumit Drini i Bardhë. Kjo njësi operative furnizon me ujë të pijes qytetin e Klinës dhe rreth 25 fshatra për rreth. Kjo njësi operative përfshin stacionin e klorinimit në qytet dhe në fshatra, katër Depo të ujit me kapacitet prej 1000m<sup>3</sup>, 800m<sup>3</sup>, 400m<sup>3</sup>, 400m<sup>3</sup> dhe 50m<sup>3</sup>, një rrjet prej 264km gyp sjellës të ujit, dy Stacione kryesore të pompimit, një Impiant të ujit të pijshëm, dhe 138km rrjetë të kanalizimit.




Fotografia 4. Harta e zonës së shërbimit të KRU "HIDRODRINI" SH.A - Komuna e Klinës

## 1.1.4 Njësitë operative të ujësjellësit – NJO Deçan

Në njësinë e Deçanit i gjithë sistemi i furnizimit me ujë është me gravitet. Qyteti i Deçanit dhe fshatrat për rreth furnizohen me ujë nga disa burime dhe atë nga burimet kryesore që vijnë në rezervuarin tek zyrat e KRU Hidrodrinit furnizohet Deçani, ndërsa janë dhe sistemet e ashtuquajtura ai i Isniqit, Strellcit, CDF-it dhe sistemi i 10 fshatrave që merr ujin në vendin e ashtuquajtur Gurrat e Hasan Agës Ekzistojnë gjashtë depo (rezervuar) me Kapacitet prej: Coopi 530m<sup>3</sup>, Nca 508m<sup>3</sup>, Strellc 720m<sup>3</sup>, dhe CDF. Të gjitha pikat janë të pajisura me klorinator.





Fotografia 5. Harta e zonës së shërbimit të KRU "HIDRODRINI" SH.A - Komuna e Deçanit



### 1.1.5 Njësitë operative të ujësjellësit – NJO Junik

Komuna e Junikut me disa fshatra përreth furnizohet nga dy burime kryesore:

1. Burimi i Gocit nga bjeshkët e Junikut dhe
2. Burimi i Shkozës

I gjithë sistemi i furnizimit me ujë është sistem me gravitet. Në këtë njësi janë dy rezervuare me kapacitet 500m<sup>3</sup> dhe 35m<sup>3</sup> dhe dy stacione të klorinimit, ndërsa gjatësia e rrjetit është 41km<sup>3</sup>.

Njësia e Junikut ka edhe ITUN, i ndërtuar vite më parë nga një donacion nga Bashkimi Evropian, mirëpo është shoqëruar me disa probleme të natyrave të ndryshme teknike dhe pronësore.



Fotografia 6. Harta e zonës së shërbimit të KRU “HIDRODRINI” SH.A. - Komuna e Junikut

## 2. Metodologjia e përpilimit të Planit të Biznesit 2026

Neni i 30 i Ligjit mbi Kompanitë Publike nr. 03ëL-087 dhe me nenin 17, 18 të Ligjit 04ëL-111 për Plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, obligon ndërmarrjet publike që të hartojnë Planin e Biznesit.

Me këtë Plan edhe Kompania KRU’’HIDRODRINI’’ SH.A. ka përcaktuar orientimet dhe objektivat e veta zhvillimore të kompanisë duke marrë për bazë rezultatet e pritshme. Janë marrë në konsideratë edhe rezultatet e së kaluarës.

Ky dokument i rëndësishëm së veçantë është përgatitur duke u bazuar në gjendjen ekzistuese socio – ekonomike, duke i ndjekur trendët e zhvillimit të sektorit të ujit në Kosovë, si dhe janë adaptuar praktikatat dhe metodat më të mira dhe më të qëndrueshme financiare dhe tekniko – teknologjike të rajonit dhe më gjerë.

Gjithashtu në të gjitha fazat e hartimit, zhvillimit dhe implementimit të gjithë dokumenteve strategjike është marrë në konsideratë edhe konteksti ekonomik dhe socio-kulturor në Republikën e Kosovës.

Gjithë akterët e kësaj Kompanie duke filluar nga Aksionari, përmes Bordit të Drejtorëve, menaxhmentit si dhe të gjithë të punësuarit do të jenë të angazhuar maksimalisht që me punën e tyre të realizojnë objektivat që dalin nga ky Plan Biznesi, në mënyrë që KRU ‘’HIDRODRINI’’ Sh.A. të arrijë të përmbushë vizionin dhe misionin e kompanisë.

Plani i Biznesit për periudhën 2026, pasi të jetë miratuar nga Bordi i Drejtorëve, i njëjti veçanërisht ai i vitit bazë (2025) do të zërbërthet në mënyrë që të përgatiten planet e detajuara të implementimit të të gjitha objektivave dhe vlerave të planifikuara.

### 2.1 Baza ligjore me ndikim të drejtpërdrejtë në ndërmarrje

Ndërmarrja Publike KRU ‘’Hidrodrini’’ Sh.A. është e organizuar si shoqëri tregtare ku aksionar është Qeveria e Republikës së Kosovës. Veprimtaria e saj operative dhe financiare do të organizohet në atë mënyrë që të përmbushë detyrimet në zbatimin e akteve dhe dispozitave ligjore të miratuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës:

- Ligji për N.Publike (nr.03/L-087);i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjet:
- Ligjit nr. 04/L-111 për Plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike;
- Ligji nr. 05/L-009 për Plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike
- Ligji nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;
- Ligji për ujërat (Ligji nr.04/L-147);
- Ligji i Punës (Ligji nr. 03/L-212);
- Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (Ligji nr.03ëL-048); i plotësuar dhe ndryshuar me ligjet:
- Ligji nr. 03ëL-221 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03ëL-048 për menaxhimin e Financave publike dhe përgjegjësitë ;
- Ligji nr.04ëL-116 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë;
- Ligji nr. 04ëL-194 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03ëL-048 për menaxhimin e Financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03ëL-221 dhe nr. 04ëL-116;
- Ligji nr. 05ëL-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03ëL-048 për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03ëL-221, nr. 04ëL-116 dhe nr. 04ëL-194;

- Ligji nr. 05ëL-007 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03ëL-048 për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr.03ëL-221, nr.04ëL-116, nr. 04ëL-194 dhe nr. 05ëL-063;
- Ligji nr.05ëL-42 për rregullimin e shërbimeve të ujit: i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr.06ëL-088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05ëL-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit.
- Ligji Nr.06ëL-082 për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Ligji për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës (Ligji nr.03ëL-064).

### 3. Deklarata e KRU “Hidrodrini” SH.A.

#### 3.1 Deklarata e Misionit

“KRU Hidrodrini është kompani publike qendrore e cila bën furnizimin me ujë të pijshëm, mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit, mbledhjen e ujërave të zeza dhe trajtimin e tyre për tërë banorët e regjionit të Pejës përmes pesë njësive të saja operative”

KRU Hidrodrini ka për mission që për të gjithë gjithë konsumatorët do të kenë trajtim dhe qasje në shërbim pa diskriminim: racor, religjioz, kombëtar apo gjinor. Implementimi i misionit të Kompanisë mund të përcillet me rreziqet eventuale të natyrave të ndryshme si: (I) mungesa e ujit në burime si pasojë e mungesës së reshjeve atmosferike; (II) kriza sociale-ekonomike në nivel të vendit ose lokal, me ndikim në mosrealizimin e të ardhurave të gatshme; (III) mosgatishmëria e donatorëve potencial në financimin e projekteve investive të nevojshme; si dhe (IV) fatkeqësitë e pa pritshme natyrore.

#### 3.2 Deklarata e Vizionit

Vizioni i KRU Hidrodrini është që deri në fund të vitit 2028 të sigurojë furnizim të pa-ndërprerë me ujë të pijes gjatë 24 orëve për tërë regjionin e Pejës, Istogut, Deçanit, Klinës dhe Junikut. Zvogëlimin e humbjeve të ujit, si dhe rritjen e Arkëtimit.

Kompania zotohet në shfrytëzimin racional të burimeve të ujit dhe në mirëmbajtjen e rregullt të rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit. Kompania është përfundimisht e orientuar në plotësimin dhe kënaqjen e kërkesave të konsumatorëve të saj, përkundër natyrës monopolistike të biznesit të saj, si dhe sigurimin e transparencës dhe bashkëpunimit me të gjithë aktet e sektorit të ujit në Kosovë dhe më gjerë.

### 4. Qëllimi dhe objektivat strategjike të KRU “Hidrodrini” Sh.A. – periudha 2026-2028

Menaxhmenti bashkë me drejtorët jo-ekzekutiv për periudhën trevjeçare 2026-2028 ka përcaktuar objektivat strategjike si në vijim:

1. Zvogëlimi i humbjeve të ujit në **75%**;
2. Redukimi i llogarive të arkëtueshme dhe rritja e inkasimit prej 5.9%
3. Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit 5% për 3 vite
4. Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit për 15% për 3 vite;

Tregues të performancës apo aktivitetet të cilat do të ndërmerren për të arritur objektivat e lartshënuara, janë përmbledhur si në vijim:

Një ndër sfidat kryesore të menaxhmentit të Kompanisë është zvogëlimi i humbjeve të ujit, hartimi i strategjive dhe implementimi i tyre në terren, nga ekipi i inxhinierëve për humbje të ujit në bashkëpunim me inspektorët dhe ekipet mbështetëse të ç'kyçjeve në terren, do të ndihmojë dukshëm në evidentimin dhe zvogëlimin e humbjeve të ujit, gjithashtu trajnimet e ndryshme në këtë drejtim. Përkushtim dhe angazhim i tërë personelit ndaj zvogëlimit të humbjeve të ujit në secilin sektor, duke bashkëpunuar me të gjithë nivelet dhe organet kompetente si ato komunale po ashtu edhe ato qendrore. Caktimi i zonave DMA, si dhe kontrolli i zonave shtëpi për shtëpi të kyçjeve ilegale, si dhe instalimin e ujëmatësve të mençur të cilët ndërpresin ujin në mënyrë automatike, si dhe e mundëson leximin nga distanca. Leximi i ujëmatësve të mençur ndihmon në leximin real të sasisë së shpenzuar të ujit, si dhe ulë keqpërdorimet e mundshme, në të njëjtën kohë kapacitetet njerëzore për këtë aktivitet zvogëlohen dhe shfrytëzohen në aktivitetet tjera të kompanisë, gjë që ndihmon në rritjen e efikasitetit të punëve dhe përmirësimin e shërbimeve. Menaxhimi i presionit të ujit, duke instaluar frekuentor si dhe skada sisteme gjë që ndihmojnë në kontrollin e presionit të ujit dhe parandalon prishjen e rrjetit të ujësjellësit. Vazhdimi i punës për identifikimin e shfrytëzuesve të pa autorizuar (keq përdorimet), Rritjen e investimeve në zëvendësimin e gypave të vjetruar, që përveç që shkakton humbjet e ujit në të njëjtën kohë shkakton edhe humbje monetare dhe pakënaqësi tek konsumatori.

- ✓ Bashkëpunim me organet ligjore në parandalimin e keqpërdorimit të ujit nga keqpërdoruesit. Trajtimi i borxheve të këqija, përmes vërejtjeve, ç'kyçjeve dhe procesimi i lëndëve me përmbarues si fazë finale. Hartimi i rregullores së Llogarive të Arkëtueshme dhe Provizionimi i borgjeve. Marrëveshje të ndryshme me Banka dhe institucione të ndryshme shtetërore që ndihmojnë në arkëtimin sa më të shpejtë të borxheve, si dhe lehtësime burokratike për konsumatorët, si p.sh. shitja e borxheve bankave fillimisht deri në tri vite e pastaj edhe borxheve të këqija (gjithnjë në bashkëpunim dhe harmonizim me rregulloret e ARRU), implementimi i projektit e-comerc për pagesa online gjë që do të ndihmojë pozitivisht në rritjen e inkasimit dhe zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme. Fushatë vetëdijesuese dhe informuese me media për pagesën e ujit dhe veprimet e kompanisë për punët në terren dhe ç'kyçjet për konsumatorët e papërgjegjshëm. Hulumtimi i industrive të ndryshme, E të cilat bëjnë shkarkimin e ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit, ndihmon për rritjen e inkasimit, si rezultat i ujërave të ndotura në impiant. Me marrëveshjet e bëra me komunat e zonës së shërbimit KRU "HIDRODRINIT" Sh.A. për marrjen nën menaxhim të rrjetit të kanalizimit, me faturimin e këtyre do të ndikoj në rritjen e inkasimit. Prioriteti i Kompanisë KRU "HIDRODRINI" SH.A. do të jetë siguria e burimeve, ku çdo burim do të jetë i siguar në formë të ndryshme të mbulimit apo rrethimit.
- ✓ Investimet kapitale me të hyrat vetanake të kompanisë në zonat e ndryshme të mbulueshmërisë që do të ndikojnë në përmirësimin e shfrytëzimit të ujit nga konsumatorët. Investimet e përbashkëta me nivelin lokal dhe atë qendror për projektet e përbashkëta. Investime të ndryshme dhe thithja e donacioneve potenciale për projektet e ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe efikasitetit të energjisë elektrike (panelevë solare), për përmirësimin e shërbimeve të konsumatorëve. Hulumtimi i burimeve të ndryshme, sidomos për zonën e Klinës që do të ndihmojë në përmirësimin e ofrimit të shërbimit të ujit të pijes e në të njëjtën kohë në zvogëlimin e harxhimeve elektrike për pompimin e ujit. Sa i përket

rrjetit të kanalizimit do të punohet në shtrirjen më të madhe të rrjetit në bashkëpunim me Komunitet e zonës.

Në kuadër të objektivave është edhe investimi në burime njerëzore përmes punësimeve të stafit, në mënyrë që të arrihet përmirësimi i cilësisë së shërbimeve. Pozitat e planifikuara janë:

- Pejë
  - Ndihmës punëtorë (ujësjellës) – 4 pozita
  - Ndihmës punëtorë (kanalizim) – 2 pozita
  - Kontabilist – 1 pozite
  - Pastruese – 1 pozite
- Klinë
  - Inspektor/e – 1 pozitë
  - Ndihmës punëtorë (ujësjellës) – 1 pozitë
- Deçan
  - Inxhinier/e – 1 pozitë
- Junik
  - Arkatar/e – 1 pozitë

\*Analizë: Nëse llogaritim pagën mesatare 650€, atëherë kosto për 1 vit për këto pozita do të jetë rreth 93600€.

#### 4.1 Vlerësimi i performancës në vitin paraprak (2025) dhe planifikimi 2026

Gjatë vitit 2025 KRUH ka performuar mirë, gjë që e pasqyrojnë edhe treguesit e performancës, sipa skëtitj vlerësimi do të hartohet edhe planifikimi për vitin 2026. Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2025 ishin:

- ✓ Arritja e kriterëve të përcaktuara nga Qeveria Gjermane Zyra Zvicerane për projektet Kosova IV, V dhe VI. (Kosova IV, përfundimi me sukses dhe në afat kohor siç është planifikuar).
- ✓ Fushatë nëpër shkollë për vetëdijësimin e nxënësve për mos hedhje të letrave të lagura në rrjetin e kanalizimit.
- ✓ Instalimi i 37 ujëmatësve dhe 36 data logger-ve (që mundëson monitorimin e prodhimit të sasisë së ujit nga distanca në kohe reale) kryesor në të gjitha burimet e njësive operative.
- ✓ Implementimi i projekteve donacion nga Zyra Zvicerane dhe Qeveria e Kosovës: Projekti i SECO për Resiliencën Klimatike në sektorin e ujit në Kosovë; investim prej 100,000.00€.
- ✓ Implementimi dhe zbatimi i punimeve në ndërtimin e fundërruesit në Klinë bashkë investim me Qeverinë e Republikës së Kosovës, KK Klinë dhe KRU “HIDRODRINI”
- ✓ Ndërrimi i Ultrafiltrave në Fabrikën e Ujit në Klinë bashkë investim me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe KRU “HIDRODRINI”
- ✓ Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit dhe stacioni i pompave për fshatrat Poqestë, Ramun, Zahaq dhe Gorazhdevc bashkëinvestim me Qeverinë e Republikës së Kosovës, KK Pejë dhe KRU “HIDRODRINI”.
- ✓ Përfundimi me sukses i projektit për rrjetin e kanalizimit donacion nga Qeveria Gjermane kfw për projektet Kosova V dhe VI.


## 5. Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitet paraprake dhe planifikimi për 2026

| Vitet             | 2023         | 2024         | 2025         | 2026         |
|-------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| Prodhimi(m³)      | 38,641,481   | 47,460,695   | 39,473,225   | 47,733,713   |
| Faturimi (m³)     | 9,953,074    | 9,922,574.66 | 12,178,500   | 10,831,313   |
| Humbjet (%)       | 74%          | 82%          | 78%          | 75%          |
| Shpenzimet (euro) | 3,510,492.59 | 3,774,584.90 | 3,901,800.00 | 5,264,492.00 |
| Inkasimet (euro)  | 3,733,100.27 | 4,062,962.97 | 5,099,600.00 | 6,316,209.00 |

Tabela 1. Prodhimi, faturimi, humbjet, shpenzimet dhe inkasimi 2023-2026

## 6. Burimet ujore, infrastruktura dhe tarifat e shërbimit

*Kompania shfrytëzon 29 burime ujore dhe mbështetet edhe nga fabrika ose Impianti i përpunimit ujit të pijes në Klinë, ku gjatë vitit 2024 fabrikës së përpunimit të ujit në Klinë i është shtuar edhe Fundërruesi i cili bënë pastrimin e ujit para filtrimit, më poshtë paraqiten vendburimet ujore, statistikatat prodhuese etj:*




Fotografia 7. Zona e shërbimit të KRU "Hidrodrini" Sh.A. – Burimet e ujit

Të gjitha këto burime janë te evidentuara dhe kanë të gjitha të dhënat për secilin veç e veç duke përfshirë: Emërtimin, Koordinatat xyz, Vendndodhjen, Tipin e burimit dhe Kapacitetin:

| Nr. | Emri i burimit                   | x             | y             | z        | Komuna | Kapaciteti (l/s) | Lloji i burimit |
|-----|----------------------------------|---------------|---------------|----------|--------|------------------|-----------------|
| 1   | Burimi Uji Zi                    | 7,439,089.76  | 4,725,019.21  | 542.00   | Pejë   | 298              | Nëntokësor      |
| 2   | Burimi Drini Bardhë              | 7,443,189.89  | 4,733,387.59  | 564.20   | Pejë   | 295              | Nëntokësor      |
| 3   | Burimi Uji Bardhë                | 7,439,004.52  | 4,724,878.97  | 542.50   | Pejë   | 50               | Nëntokësor      |
| 4   | Burimi Istog 1                   | 7,457,551.25  | 4,738,925.91  | 516.99   | Istog  | 312              | Nëntokësor      |
| 5   | Burimi Istog 2                   | 7,457,596.45  | 4,738,953.28  | 534.61   | Istog  | 312              | Nëntokësor      |
| 6   | Burimi Javor 1                   | 7,466,205.25  | 4,746,684.18  | 1,434.21 | Istog  | 1                | Nëntokësor      |
| 7   | Burimi Javor 2                   | 7,466,678.09  | 4,746,406.66  | 1,283.38 | Istog  | 1                | Nëntokësor      |
| 8   | Burimi Vrellë                    | 7,450,853.44  | 4,737,414.95  | 551.92   | Istog  | 82               | Nëntokësor      |
| 9   | Burimi Vojdullë 3                | 7,465,298.89  | 4,747,590.59  | 1,271.11 | Istog  | 5.7              | Nëntokësor      |
| 10  | Burimi Vojdullë 2                | 7,465,409.89  | 4,747,847.59  | 1,292.58 | Istog  |                  | Nëntokësor      |
| 11  | Burimi Vojdullë 1                | 7,465,216.89  | 4,748,202.59  | 1,341.78 | Istog  |                  | Nëntokësor      |
| 12  | Burimi Kosharishtë               | 7,462,786.89  | 4,745,996.59  | 1,438.53 | Istog  |                  | Nëntokësor      |
| 13  | Burimi Shkozë                    | 7,441,031.22  | 4,706,464.34  | 544.50   | Junik  | 20 - 64          | Nëntokësor      |
| 14  | Burimi Goç                       | 7,435,978.41  | 4,704,868.35  | 1,225.50 | Junik  | 14 - 36          | Nëntokësor      |
| 15  | Burimi Jarina                    | 7,467,768.76  | 4,720,278.83  | 420.00   | Klinë  | 300              | Nëntokësor      |
| 16  | FTU                              | 7,464,748.10  | 4,720,334.85  | 378.00   | Klinë  | 100              | Lum             |
| 17  | Burimi Garabili                  | 7,467,854.54  | 4,709,391.22  | 460.00   | Klinë  | 45               | Nëntokësor      |
| 18  | Burimi Kpuz                      | 7,461,232.49  | 4,710,988.29  | 375.00   | Klinë  | 10               | Pus             |
| 19  | Burimi Rastoka                   | 7,463,928.59  | 4,713,202.01  | 362.00   | Klinë  | 7                | Pus             |
| 20  | Burimi Berkov                    | 7,461,433.40  | 4,726,128.69  | 404.00   | Klinë  | 8                | Pus             |
| 21  | Pusi për Svergë                  | 7,467,848.182 | 4,709,372.762 | 452.50   | Klinë  | 1.3              | Pus             |
| 22  | Burimi 1                         | 7,435,876.72  | 4,712,632.30  | 766.01   | Deçan  | 30               | Nëntokësor      |
| 23  | Burimi 2                         | 7,435,471.02  | 4,712,852.20  | 780.98   | Deçan  | 32               | Nëntokësor      |
| 24  | Burimi 3                         | 7,434,467.72  | 4,712,765.70  | 1,020.83 | Deçan  | 28               | Nëntokësor      |
| 25  | Burimi Rakita                    | 7,438,621.82  | 4,716,206.51  | 1,210.20 | Deçan  | 10               | Nëntokësor      |
| 26  | Burimi Gurrat e Bardha           | 7,438,222.00  | 4,717,050.07  | 1,570.50 | Deçan  | 7                | Nëntokësor      |
| 27  | Burimi Isniqit                   | 7,438,336.30  | 4,712,947.96  | 707.10   | Deçan  | 26               | Nëntokësor      |
| 28  | Burimi i Kurvalles dhe Hasanages | 7,430,446.607 | 4,712,767.373 | 1,768.20 | Deçan  | 2.2              | Nëntokësor      |
| 29  | Burimi nga Drenazhet e CDF       | 7,438,339.694 | 4,712,946.946 | 805.10   | Deçan  | 2.4              | Drenazhet       |

Tabela 2. Burimet e ujit



**Fotografia 8. Zona e shërbimit të KRU “Hidrodrini” Sh.A. – Burimet e ujit 2**


Po ashtu një përqindje e konsiderueshme e rrjetit është e ndarë në zona të matura DMA përmes të cilave është shumë e lehtë të bëhet hulumtimi i UPF, e veçanërisht në qytetin e Pejës janë mbi 40 zona të matura.

Gjatë viteve të ardhshme do të punohet që edhe në njësitë tjera të krijohen sa më shumë zona të matura dhe të bëhet instalimi i matësve të mençur në mënyrë që të bëjmë zvogëlimin e UPF sa më shumë që është e mundur dhe të plotësohen kriteret e vendosura nga NPMNP, ARRU, KNM e faktorë të tjerë relevant të sektorit të ujërave.

KRU “Hidrodrini” Sh.A., në të gjithë zonën e shërbimit - ka në menaxhim rreth  $L=514$  km të rrjetit të largimit të ujërave të ndotura, me dimensione dhe materiale të ndryshme. Në të shumtën e rasteve ky rrjet është i përzier edhe me kanalizimin e ujërave atmosferike. Kompania përmes personelit, mekanizmit dhe pajisjeve teknike që posedon, bën: pastrimin, de bllokimin dhe sanimin në çdo kohë dhe në çdo vend në zonën e shërbimit të gjitha defekteve, bllokimeve dhe pengesave tjera në kolektorë.

Në vitin 2024 është marrë nën shërbim edhe mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit pas marrëveshjes së bërë nga KRU Hidrodrini dhe Komuna e Deçanit si dhe me të gjitha komunat e mbulueshmërisë.

Po ashtu është bërë një bashkëpunim me pesë komunat e zonës së shërbimit që të bëjmë incizimin e rrjetit të shpërndarë të kanalizimit nëpër fshatra dhe futja e të dhënave në GIS.



**Fotografia 9. Rrjeti i kanalizimit i ndarë në bazë të kolektorëve**

Në këtë hartë është i paraqitur rrjeti i kanalizimit në qytetin e Pejës i ndarë në bazë të kolektorëve dhe sipërfaqës së zonave të mbledhjes së ujërave të zeza. Po ashtu janë të regjistruara të gjitha pusetat duke përfshirë të gjitha të dhënat për secilën pushtë.

## **6.1 Impiantet e ujit të pijes dhe trajtimi të ujërave të ndotura**

Kompania Rajonale e Ujësjesit “HIDRODRINI” SH.A krahas 29 burimeve që i shfrytëzon për furnizim të konsumatorëve me ujë, ndihmohet edhe nga Impianti i trajtimit të ujit të pijes i cili ndodhet në Klinë, pastaj edhe ujërat e ndotura (kanalizimet) trajtohen në Impiantin tjetër i cili ndodhet në Pejë e që të dyjat së bashku janë të trajtuara me gjerësisht në pjesën e më poshtme.

### **6.1.1 Impianti i Trajtimit të Ujit për Pije (ITUP) dhe Fundërruesi (para filtrimi) - Klinë**

Në kuadër të zonës së shërbimit të cilën e mbulon KRU “Hidrodrini” SH.A., posedon edhe një impiant për përpunimin e ujit, i cili ndodhet në Klinë.

Ky impiant është investim i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komunës së Klinës, punimet e tij kanë përfunduar në Mars 2013, po atë kohë janë bërë edhe testet e para, ku më saktësisht në Shkurt të vitit 2015 është lëshuar në përdorim.

Në këtë fabrikë i gjithë procesi është i automatizuar falë instalimit të PLC të prodhuesit “Siemens Simatic S7”, Pompat furnizojnë sektorin e Mikrofiltrave (filtrat me disqe 10 mikrometra), ku këta filtra janë të lidhur me PLC, pasi varësisht nga ndotja e ujit nga rezervuari filtrat kanë nevojë të kryejnë procesin e shprëlarjes (backwashing). Pastaj uji i trajtuar me mikrofiltra futet në ultra filtrat e POLIMERIT të cilët kanë një nivel pastërtie deri 0.01 mikrometra.



**Fotografia 10. Pamje e ITUP në Klinë**

Komponentët kryesorë të këtij projekti janë:

- Marrja e ujit nga Lumi Drini i Bardhë dhe nga Puset
- Filtrimi i parë në filtrat e Disk-Filtrat apo Mikro filtrat
- Filtrimi në Ultra filtra (0.01 mikrometra)
- Sistemi i backwashing – vetë pastrimit përmes shtypjeve të krijuara në filtra
- Sistemi i pastrimit të filtrave me Klor – CIP Cleaning
- Rezervuarët, Stacionet e pompave deri 160kW, Klorinimi etj.
- Kapaciteti maximal i projektuar është 83 l/s



**Fotografia 11. Pamje e brendshme e ITUP në Klinë**

Kjo fabrikë furnizon qytetin e Klinës dhe disa fshatra të saja, është e vendosur buzë lumit të Drinit të Bardhë ku uji vjen sipas skemës së më poshtme do shohim sektorët e punës së fabrikës së ujit.

Fabrika ka pasur probleme në funksionimin normal, për shkak të ndotjes së filtrave, është duke u bërë investimi nga KRUH në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës që të bëjnë ndërrimin e filtrave dhe në të ardhmen rritjen e kapaciteteve të prodhimit.

Në nëntor 2025 është lëshuar në funksion Fundërruesi (vlera e investimit 850,000.00 euro) i cili do të filtrojë ujin për fabrikën ekzistuese duke bërë para filtrimin. Filtrohen deri 80l/s për qytetin dhe rrethinën e Klinës.



Fotografia 12. Fundërruesi

### 6.1.2 Impianti për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN) - Pejë

Ujërat e ndotura trajtohen në ITUN në Pejë, përkatësisht në fshatin Gorazhdec, ujërat e ndotura që derdhën në këtë implant, përbëhen nga ujërat e ndotura shtëpiake, tregtare dhe industriale (Fabrika e “Birra Peja”, hira e Fabrikës “Rugove” etj). Këto mblidhen nga një kanalizim i ri kryesor, i cili është ndërtuar në të njëjtën kohë.

Komponentët kryesorë të këtij projekti janë:

- Një ITUN me një kapacitet prej 81,000 ekuivalentë të popullsisë (Banor Ekuivalent);
- Në fazën e dytë të projektit në vitet e ardhshme përshihet investimi në adaptimin e implantit për 96,000 Banor Ekuivalent nga BE;
- Tani më ekzistues është kanalizimi prej rreth 7.615 km në total dhe objektet e lidhura;
- Në këtë fazë janë vetëm rreth 5 ha të terrenit, dhe 9.84 ha për të operuar objekti dhe për të arritur standardet përkatëse të trajtimit. Pjesa tjetër prej 4,84 ha janë e mjaftueshme për të akomoduar njësi të procesit shtesë në Fazën e II-të të projektit;
- Ekzistojnë pesë (5) seksione të koleksionistëve kryesor nga pikat ekzistuese të shkarkimit D2, D4, D5 dhe D6 në rrjetin e transmisionit. Gjatësia totale: 4,015m;
- Gjersa janë dy (2) seksione të rrjetit të transmisionit (MC1.1 dhe MC1.2). Gjatësia totale: 2.305 m;
- Janë dy (2) seksione të gypave të presionit të lidhur për fshatin Gorazhdec dhe aglomeratet ngjitur në ITUN. Gjatësia totale: 1.295 m;



**Fotografia 13. Pamje nga lartë e ITUN në Pejë**

Impianti përfshinë: Stacionin e pompimit të para-trajtimin mekanik dhe hyrjes; Trajtimi biologjik; Trajtimi i llumit; Trajtimi i Biogazit; Përdorimi i Biogazit dhe Komponentët e impianteve ndihmëse.

### **6.1.3 Trajtimi i ujërave të ndotura komunale në ITUN Peja**

Trajtimi i ujërave të ndotura komunale në ITUN Peja kalon nëpër disa faza të cilat do të paraqiten si me poshtë:

**Trajtimi parësor:** Faza e trajtimit parësor përfshinë ndarjen fizike të materialeve të ngurta nga ujërat e ndotura. Kjo zakonisht bëhet duke përdorur rrjeta ndarëse dhe rezervuar sedimentimi për të hequr mbeturinat e mëdha dhe lëndët e ngurta të vendosura.

**Trajtimi sekondar:** Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura komunale në Pejë përbën një kombinim të proceseve aerobike dhe anaerobe, sa i përket trajtimit dytësor trajtimin aerobik: e cila arrihet përmes llumit të aktivizuar. Në sistemet e llumit të aktivizuar, mikroorganizmat shtohen në ujërat e ndotura për të zbërthyer lëndën organike dhe përzierja ajroset për të nxitur rritjen e tyre.

**Trajtimi anaerobik:** Tretja anaerobe është një proces ku mikroorganizmat shpërbëjnë lëndën organike në mungesë të oksigjenit. Kjo është pjesë e procesit të trajtimit të llumit të krijuar në fazat e trajtimit parësor dhe dytësor. Tretja anaerobe në rastin tonë prodhon biogaz si nën produkt, i cili përdoret për prodhim të rrymës elektrike.

**Dezinfektimi:** Pas fazave të trajtimit dytësor dhe terciar, efluenti dezinfektohet për të vrarë çdo patogjen të mbetur, në rastin tonë janë të vendosur UV rrezatim.

**Menaxhimi i llumit:** Llumi i prodhuar gjatë procesit të trajtimit (si primar ashtu edhe sekondar) depërtohet dhe trajtohet për të zvogëluar volumin e tij dhe për të hequr patogjenët. Biosolidet që rezultojnë mund të përdoren në bujqësi ose të asgjësohen në mënyrë të kontrolluar.

**Shkarkimet e rrjedhës:** Ujërat e ndotura të trajtuara, tani të quajtura efluent, zakonisht shkarkohen në Lumbardh, ose ripërdoren për qëllime jo të pijshme.

**Pajtueshmëria me mjedisin:** Impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura komunale duhet t'u përmbahen rregulloreve strikte mjedisore për të siguruar që efluenti i trajtuar të jetë i sigurt për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

#### 6.1.4 Aspektet operacionale

Përshkrimi i procesit të trajtimit të llumit përbëhet nga një proces i tretjes anaerobe (këtu është tretja mezofilike), njësia e kombinimit të nxehtësisë dhe energjisë për rikuperimin e energjisë së biogazit të gjeneruar, tretjes mekanike të llumit nga centrifuga dhe zona e deponimit të llumit. Vendimi për procesin e tretjes së propozuar u bazua në një analizë të opsioneve (aerobik dhe anaerobike) të përgatitura nga Konsulenti Implementues (Dahlem) duke marrë parasysh aspektet energjetike, konstruktive dhe të efikasitetit të kostos. Ekziston një kontenier trajtues (digester) anaerob mesofilik të dimensionuar për një kohë mbajtjeje prej 21 ditësh me një volum prej rreth 2,200 m<sup>3</sup>.



**Fotografia 14. Pamje nga lartë i ITUN në Pejë - 2**

Kontenieri trajtues operon 37 ° C. Shkëmbyesi i nxehtësisë, pompat e ri-qarkullimit, njësitë dhe trajtimi i gazit është i vendosur në një ndërtesë ngjitur me makineritë. Procesi i tretjes dhe prodhimi i biogazit reduktojnë përmbajtjen organike të llumit. Kjo qon në zvogëlimin e vëllimit të llumit dhe patogjenëve. Duke reduktuar përmbajtjen organike të llumit, ujërat e zeza përmirësohen ndjeshëm. Drenazhimi mekanik i llumit me centrifugë është propozuar për të zvogëluar volumin e llumit dhe për të rritur përmbajtjen e materieve të ngurta në 20%. Pas heqjes mekanike llumi do të ruhet në një depo të caktuar (sipërfaqja: 750 m<sup>2</sup>). Nga ky objekt i mbuluar llumi mund të përpunohet më tej për opsionet e ripërdorimit ose të deponimit të caktuar.

#### 6.2 Tarifat e shërbimit

Përgjegjësi për rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimit të ujit në Republikën e Kosovës, është Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU). Roli i ARRU është që të sigurojë ofrimin e shërbimeve cilësore, eficiente, dhe të sigurta në baza jo-diskriminuese për tërë konsumatorët në Kosovë, duke pasur parasysh mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik. Më poshtë përmes tabelave, janë të paraqitura

Urdhëresat Tarifore të Shërbimeve (UTSH), të caktuara nga ARRU për Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit “HIDRODRINT”:

| Kategoria e konsumatorëve                 | Tarifa Volumetrike për Shërbimet e Ujësjellësit (EUR/m <sup>3</sup> ) | Tarifa Volumetrike për Shërbimet e ujërave të ndotura (EUR/m <sup>3</sup> ) |
|-------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------|
| Shtëpiak                                  | 0.3949                                                                | 0.1558                                                                      |
| Jo-shtëpiak (komercial dhe institucional) | 0.5133                                                                | 0.2961                                                                      |

Tabela 3. Tarifat volumetrike për aktivitetet themelore të ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura për vitin 2026

Tarifa fikse ka qenë 1EUR/muaj për konsumatorë shtëpiak dhe 2EUR/muaj për konsumatorë jo-shtëpiak (komercial dhe institucional), ndërsa nga viti 2026 aplikohen tarifat e reja në bazë të diametrit të kyçjes në rrjetin shpërndarës.

| Diametri i kyçjes në rrjetin shpërndarës          | Njësia        | Vlera   |
|---------------------------------------------------|---------------|---------|
| Konsumatorët vetëm me lidhje të ujërave të ndotur | EURëkonsëmuaj | 0.6520  |
| 15mm                                              | EURëkonsëmuaj | 1.3040  |
| 20mm                                              | EURëkonsëmuaj | 1.3040  |
| 25mm                                              | EURëkonsëmuaj | 2.0864  |
| 32mm                                              | EURëkonsëmuaj | 2.0864  |
| 40mm                                              | EURëkonsëmuaj | 8.4500  |
| 50mm                                              | EURëkonsëmuaj | 8.4500  |
| 65mm                                              | EURëkonsëmuaj | 20.8642 |
| 80mm                                              | EURëkonsëmuaj | 20.8642 |
| 100mm                                             | EURëkonsëmuaj | 25.6630 |
| 125mm                                             | EURëkonsëmuaj | 25.6630 |
| 150mm                                             | EURëkonsëmuaj | 40.4765 |
| 200mm                                             | EURëkonsëmuaj | 40.4765 |
| 250mm                                             | EURëkonsëmuaj | 56.3333 |

Tabela 4. Tarifa fikse mujore

| Kategoria e konsumatorëve                              | Diametri i gypit të lidhjes                                               | Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim (EUR) |
|--------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|
| Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe institucional) | Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarësëgrumbullues dhe ujëmatësve | 10.00                                     |

Tabela 5. Tarifa për inspektimin e lidhjes së re në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit

#### Shënim:

- Pasi që kjo tarifë përfshinë kryesisht shpenzime fikse, atëherë e njëjta shumë (d.m.th 10 EURO) do të paguhet kur inspektimi: (i) për lidhjet në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit,

kur ekzistojnë të dyja bashkë; dhe (ii) kur ekziston kërkesa për njërin shërbim.

- Kjo tarifë nuk aplikohet kur lidhja e re realizohet nga Kompania, me ç ‘rast duhet të aplikohet vetëm tarifa: “Tarifat për realizimin fizik të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit”.
- Kjo tarifë nuk aplikohet në rastet kur lidhja e re realizohet nga kompanitë e autorizuar përmes donacioneve, pasi që tërë projekti (përfshirë edhe lidhjet) i nënshtrohen pranimit teknik.

| Kategoria e konsumatorëve                              | Diametri i gypit të lidhjes | Tarifa e lidhjes (pa pusëtë)* (EUR) | Tarifa e lidhjes (me pusëtë, pa asfaltim)** (EUR) | Tarifa totale (lidhja, puseta, asfaltimi)*** (EUR) |
|--------------------------------------------------------|-----------------------------|-------------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------------------------|
| Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe institucional) | 15 mm                       | 80.00                               | 240.00                                            | 490.00                                             |
|                                                        | 20 mm                       | 80.00                               | 240.00                                            | 490.00                                             |
|                                                        | 25 mm                       | 100.00                              | 260.00                                            | 510.00                                             |
|                                                        | 32 mm                       | 140.00                              | 300.00                                            | 550.00                                             |
|                                                        | 40 mm                       | 180.00                              | 340.00                                            | 590.00                                             |
|                                                        | 50 mm                       | 370.00                              | 530.00                                            | 780.00                                             |
|                                                        | 65& 75 mm                   | 490.00                              | 650.00                                            | 900.00                                             |
|                                                        | 80 mm                       | 625.00                              | 785.00                                            | 1,035.00                                           |
|                                                        | 100mm                       | 780.00                              | 940.00                                            | 1,190.00                                           |

Tabela 6. Tarifat për realizimin fizik të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit

#### Shënim:

- Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh vetëm realizimin e lidhjes (pa përfshirë ndërtimin e pusëtës);
- Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh realizimin e lidhjes dhe ndërtimin e pusëtës, ndërsa nuk ka kërkesë për asfaltim;
- Aplikohet në rastet kur gypi i shërbimit gjendet në rrugë apo trotuar kur kompania pas punimeve është e obliguar të kthejë rrugën apo trotuarin në gjendjen e mëparshme.

| Kategoria e konsumatorëve                             | Diametri i gypit të lidhjes | Tarifa e lidhjes (pa pusëtë) *(EUR) | Tarifa e lidhjes (me pusëtë, pas asfaltimit) ** (EUR) | Tarifa totale (lidhja, puseta, asfaltimi) *** (EUR) |
|-------------------------------------------------------|-----------------------------|-------------------------------------|-------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|
| Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak(komercial dhe institucional) | 160mm                       | 26.00                               | 153.00                                                | 403.00                                              |
|                                                       | 200mm                       | 36.00                               | 163.00                                                | 413.00                                              |
|                                                       | 250mm                       | 46.00                               | 173.00                                                | 423.00                                              |
|                                                       | 315mm                       | 76.00                               | 203.00                                                | 453.00                                              |

Tabela 7. Tarifat për realizimin fizik të lidhjes në rrjetin e kanalizimit

#### Shënim:

- Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh vetëm realizimin e lidhjes (pa përfshirë ndërtimin e pusëtës);
- Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh realizimin e lidhjes dhe ndërtimin e pusëtës, ndërsa nuk ka kërkesë për asfaltim;
- Aplikohet në rastet kur puseta gjendet në rrugë apo trotuar kur Kompania pas punimeve është e obliguar të kthejë rrugën apo trotuarin në gjendjen e mëparshme.

| Kategoria e konsumatorëve                              | Diametri i gypit të lidhjes                                               | Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim (EUR) |
|--------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|
| Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe institucional) | Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarësëgrumbullues dhe ujëmatësve | 10.00                                     |

Tabela 8. Tarifa për ndërprerjen e përkohshme të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit

| Kategoria e konsumatorëve                              | Diametri i gypit të lidhjes                                               | Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim (EUR) |
|--------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|
| Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe institucional) | Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarësëgrumbullues dhe ujëmatësve | 20.00                                     |

Tabela 9. Tarifa për ndërprerjen e përhershme të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit

| Kategoria e konsumatorëve                              | Diametri i gypit të lidhjes                                               | Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim (EUR) |
|--------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|
| Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe institucional) | Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarësëgrumbullues dhe ujëmatësve | 10.00                                     |

Tabela 10. Tarifa për ri-lidhje në rrjetin e ujësjellësit (pas ndërprerjes së përkohshme)

| Kategoria e konsumatorëve                              | Diametri i gypit të lidhjes | Tarifa për ujësjellës(EUR) |
|--------------------------------------------------------|-----------------------------|----------------------------|
| Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe institucional) | 20 mm                       | 16.50                      |
|                                                        | 25 mm                       | 16.50                      |
|                                                        | 32 mm                       | 16.50                      |
|                                                        | 40 mm                       | 18.00                      |
|                                                        | 50 mm                       | 18.00                      |
|                                                        | 63 mm                       | 18.00                      |
|                                                        | 75 mm                       | 19.00                      |
|                                                        | 90 mm                       | 19.00                      |
|                                                        | 110mm                       | 19.00                      |

Tabela 11. Testimi i ujëmatësit për siguri të matjes

#### Shënim:

- Kjo tarifë aplikohet konform nenit 28 të Rregullores 10ë2019 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë.

| Kategoria e shërbimit | Njësia         | Vlera    |
|-----------------------|----------------|----------|
| Ujësjellës            | EURëkonsumator | 135.6173 |
| Kanalizim             | EURëkonsumator | 99.1049  |

Tabela 12. Tarifa e mbi-ngarkesës (përforcimit) së infrastrukturës

Tarifa e mbi-ngarkesës zbatohet për çdo konsumator të ri që kyçet në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit sipas letrës zyrtare të ARRU me nr. prot. 938/D, datë 25.11.2024.

## 7. Departamenti teknik

Departamenti teknik në KRU ka një rol thelbësor në sigurimin e një infrastrukture të qëndrueshme dhe efikase për furnizimin me ujë. Departamenti Teknik merret me planifikimin, projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, duke garantuar që ato të funksionojnë në mënyrë optimale. Stafi në kuadër të Departamentit Teknik analizon dhe monitoron performancën e rrjetit, identifikojnë defektet dhe planifikojnë intervenimet për sanimin e tyre, duke minimizuar humbjet dhe rrezikun e ndotjes së ujit.

Rëndësia e departamentit teknik shtrihet përtej mirëmbajtjes së zakonshme. Ai kontribuon në inovacionin dhe përmirësimin e proceseve, duke aplikuar teknologji të reja dhe praktika të qëndrueshme për menaxhimin e burimeve ujore dhe zvogëlimin e humbjeve të ujit. Gjithashtu, ky departament luan një rol kyç në përmbushjen e standardeve mjedisore dhe të shëndetit publik, duke siguruar që ujësjellësi të operojë brenda kuadrit ligjor dhe të respektojë normat e cilësisë së ujit.

Përveç kësaj, departamenti teknik ofron mbështetje për menaxhimin strategjik të kompanisë, duke ofruar analiza dhe rekomandime për investime në infrastrukturë dhe zhvillim të qëndrueshëm. Në këtë mënyrë, Departamenti Teknik ndihmon KRU-në të përballojë sfidat e rritjes së kërkesës për ujë dhe të ruajë burimet natyrore për brezat e ardhshëm.

### 7.1 Organizimi i Departamentit Teknik

Departamenti Teknik është i organizuar në katër divizione kryesore, secila me funksione specifike:

#### 1. Furnizimi me Ujë të Pijshëm

- Përgjegjës për mirëmbajtjen dhe operimin e rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm;
- Menaxhon stacionet e pompimit dhe rezervuarët;
- Përfshin impiantin e ujit të pijshëm.

#### 2. Ujërat e Ndotura

- Përfshin mirëmbajtjen dhe operimin e kanalizimit.

#### 3. ITUN (Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura)

- Përfshin mirëmbajtjen dhe operimin e ITUN-it;
- Përfshin menaxhimin e llumit;
- Ka një laborator të dedikuar për ITUN.

#### 4. Planifikimi & Zhvillimi

- Përfshin UPF (DMA) për menaxhimin e presionit të ujit;
- Përfshin GIS për menaxhimin e informacionit gjeografik;

- Përfshin menaxhimin e aseteve dhe investimeve;
- Përfshin menaxhimin e projekteve.

Ky strukturim i ndihmon departamentit të menaxhojë dhe operojë të gjitha aspektet e furnizimit dhe trajtimit të ujit.

## **Objektivat kryesore të Departamentit Teknik**

Objektivat e Departamentit Teknik, orientohen në dy shtylla kryesore siç janë:

- Identifikimi i kërkesave të infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit të Kompanisë përgjatë periudhës së ardhshme duke marrë parasysh trendin e rritjes dhe zhvillimit të zonës së shërbimit që është nën menaxhim të Kompanisë.
- Planifikimi i investimeve të infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit, bazuar në kërkesat që vijnë si rezultat i projeksioneve demografike dhe zhvillimore në zonën e shërbimit, apo si rezultat i kërkesave rregullatore për nivelin e shërbimeve dhe faktorëve tjerë (ndryshimet klimatike, vjetërsia e infrastrukturës etj.).

Kompania është e përkushtuar për ndërmarrjen e të gjitha aktiviteteve investive dhe operative me qëllim të krijimit të një infrastrukture të konsoliduar të ujësjellësit dhe kanalizimit, në interes të ofrimit të shërbimeve cilësore për konsumatorët e vet, jo vetëm sot por edhe në të ardhmen.

## **Prodhimi i ujit**

Zona e shërbimit të KRU “Hidrodrini” shtrihet në pesë komuna, të cilat janë:

1. Komuna e Pejës,
2. Komuna e Istogut,
3. Komuna e Klinës,
4. Komuna e Deçanit dhe
5. Komuna e Junikut.

Për secilën nga këto komuna ka pika të veçanta prej nga merret uji, trajtohet, duke i plotësuar standardet sipas ligjeve në fuqi, dhe pastaj u dërgohet konsumatorëve për pije.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, në secilën nga këto pika ku merret uji, janë vendosur ujëmatës përkatës të cilët bëjnë matjen e saktë të sasisë së ujit që futet në sistemin e rrjetave të ujësjellësve të njësive përkatëse.

## **Defektet në rrjetin e ujësjellësit**


Gypat e ujësjellësit luajnë një rol kyç në shpërndarjen e ujit të pijshëm, dhe çdo defekt në sistem mund të rezultojë në humbje të mëdha, ndotje të ujit dhe rrezik për shëndetin e publikut. Sanimi i shpejtë dhe efikas i defekteve ndihmon në minimizimin e humbjeve të ujit, reduktimin e kostove operative dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

Përveç kësaj, ndërhyrjet e rregullta në sistemin e ujësjellësit janë të domosdoshme për të garantuar që infrastruktura të qëndrojë e qëndrueshme dhe e aftë për të përballuar kërkesat në rritje për ujë, duke mbrojtur kështu burimet natyrore dhe ambientin. Prandaj, investimi në sanim dhe mirëmbajtje të gypave është një përparësi strategjike për KRU-në që kërkon të sigurojë një furnizim të sigurtë dhe cilësor me ujë.

KRUH i kushton një rëndësi të madhe sanimit të shpejtë të defekteve në sistemin e ujësjetës, e cila është një nga aktivitetet kryesore të saj. Angazhimi për zgjidhjen e menjëhershme të çdo problemi garanton që furnizimi me ujë të mbetet i pandërprerë dhe i sigurt për konsumatorët. Me një ekip të specializuar dhe teknologji të avancuara, kompania synon të reduktojë ndjeshëm kohën e ndërhyrjes, duke minimizuar kështu humbjet e ujit dhe duke përmirësuar efikasitetin operacional. Kjo qasje pro aktive, jo vetëm që rrit cilësinë e shërbimeve, por gjithashtu ndihmon në ruajtjen e burimeve natyrore, duke kontribuar në një menaxhim më të qëndrueshëm të ujit.


Tabelari më poshtë tregon kohëzgjatjen e riparimit në bazë të diametrave për kushte normale, ka shumë faktorë të tjerë që ndikojnë në zgjatjen e kohës së riparimeve.

|   | Lloje i prishjes në bazë të diametrit | Kohëzgjatja e riparimit në kushte normale |
|---|---------------------------------------|-------------------------------------------|
| 1 | Nga 20 mm deri në 40 mm               | 60 minuta                                 |
| 2 | Nga 50 mm deri në 90 mm               | 90 minuta                                 |
| 3 | Nga 110 mm deri në 160 mm             | 120 minuta                                |
| 4 | Nga 200 mm deri në 315 mm             | 180 minuta                                |
| 5 | Nga 350 mm deri në 500 mm             | 240-300 minuta                            |



Fotografia 15. Rrjeti i ujësjetës sipas diametrit në të gjithë zonën e shërbimit të KRUH

## Rrjeti i kanalizimit



Fotografia 16. Rrjeti i kanalizimit në të gjithë zonën e shërbimit të KRUIH

## 7.2 Sektori i GIS

Sektori i GIS-it merret me incizimin e rrjetit të ujësjellësit (gypat primar, sekondar dhe terciar, valvulat, hidrantët, pusetat e ujësjellësit), rrjetin e kanalizimit (gypat, pusetat, pikat e shkarkimit), konsumatorët (ujëmatësit, pusetat e ujëmatësve, gypat shtëpiak, shtëpitë dhe ndërtesat), rrjetin atmosferik (gypat, pusetat, drenazhat), sistemi i adresave (emrat e rrugëve, numrat e objekteve), defektet (rrjedhjet, prishjet), krijimin dhe mirëmbajtjen e platformës së ArcGIS Online (web aplikacione, web harta, harta për terren etj).

| Njësia | Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit | Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit të digjitalizuar në GIS | Përqindja e digjitalizimit të rrjetit |
|--------|------------------------------------|------------------------------------------------------------|---------------------------------------|
| Pejë   | 467 km                             | 467 km                                                     | 100 %                                 |
| Istog  | 344 km                             | 344 km                                                     | 100 %                                 |
| Deçan  | 186 km                             | 186 km                                                     | 100 %                                 |
| Klinë  | 264 km                             | 264 km                                                     | 100 %                                 |
| Junik  | 41 km                              | 41 km                                                      | 100 %                                 |
| Totali | <b>1,302 km</b>                    | <b>1,302 km</b>                                            | 100 %                                 |

Tabela 13. Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit sipas njësive në KRUH

**Shënim:** Gjatësia totale e rrjetit të ujësjellësit në zonën e shërbimit të KRU Hidrodrini është 1,302 km. Numri i popullatës që KRU “Hidrodrini” iu ofron shërbime të furnizimit me ujë është rreth 202,564 banorë, prej 220,338 sa janë gjithsejt. Mbulueshmëria me shërbime të ujit të pijshëm në zonën e shërbimit është 91%. Numri i vendbanimeve me shërbime të ujësjellësit është 168, nga 223 sa janë gjithsejt në zonën e shërbimit.

| Kategoria e aseteve                      | Numri i aseteve sipas databazës së KRU-së | Numri i aseteve të vlerësuara sipas PMA | Përqindja e vlerësimit të aseteve sipas PMA |
|------------------------------------------|-------------------------------------------|-----------------------------------------|---------------------------------------------|
| Fabrikat e përpunimit të ujit            | 1                                         | 1                                       | 100%                                        |
| Stacionet e pompimit                     | 41                                        | 41                                      | 100%                                        |
| Rezervuarët e ujit                       | 28                                        | 28                                      | 100%                                        |
| Burimet e ujit                           | 29                                        | 29                                      | 100%                                        |
| Impianti për trajtimin e ujerave te zeza | 1                                         | 1                                       | 100%                                        |

Tabela 14. Asetet jo-infrastrukturore të KRUH

| Njësia | Gjatësia e rrjetit të kanalizimit | Gjatësia e rrjetit të kanalizimit të digjitalizuar në GIS | Përqindja e digjitalizimit të rrjetit |
|--------|-----------------------------------|-----------------------------------------------------------|---------------------------------------|
| Pejë   | 467 km                            | 467 km                                                    | 100 %                                 |
| Istog  | 344 km                            | 344 km                                                    | 100 %                                 |
| Deçan  | 186 km                            | 186 km                                                    | 100 %                                 |
| Klinë  | 264 km                            | 264 km                                                    | 100 %                                 |
| Junik  | 41 km                             | 41 km                                                     | 100 %                                 |
| Totali | <b>514 km</b>                     | <b>514 km</b>                                             | 100 %                                 |

Tabela 15. Gjatësia e rrjetit të kanalizimit sipas njësive në KRUH

**Shënim:** Gjatësia totale e rrjetit të kanalizimit në zonën e shërbimit të KRU Hidrodrini është 514 km. Numri i popullatës që KRU Hidrodrini iu ofron shërbime të kanalizimit është rreth 155,934 banorë, prej 220,338 sa janë gjithsejt. Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura (rrjetit të kanalizimeve) në zonën e shërbimit është 69%, ndërsa mbulueshmëria me shërbime për përpunimin e ujërave të ndotura është 45% nga totali me shërbime të kanalizimit, apo 31% nga totali i popullsisë. Numri i vendbanimeve me shërbime të kanalizimit është 107, nga 223 sa janë gjithsejt në zonën e shërbimit.

**Shënim:** Vlerësimi i aseteve infrastrukturore (nëntokësore) është bërë në mënyrë të automatizuar përmes modelit të gjeo-përpunimit (Model Builder) në ArcGIS, duke përdorur të dhënat e mëposhtme si tregues të shërbyeshmërisë dhe kritikalitetit:

- Gypat (materiali, diametri, viti i instalimit);
- Jetëgjatësia e mbetur e gypave (jetëgjatësia e pritur, jetëgjatësia e mbetur);
- Defektet për kilometër të gypit (numri i defekteve, defektet për km të gypit);
- Kritikaliteti i gypave (lokacioni, konsumatorët kyç, numri i konsumatorëve që furnizohen nga gypi i caktuar etj).

KRU Hidrodrini përdor platformën ArcGIS Desktop që nga viti 2010 për të digjitalizuar dhe ruajtur të dhënat, ArcGIS Pro dhe ArcGIS Online për të publikuar të dhënat në ëeb harta dhe ëeb aplikacione. Të gjitha të dhënat sa i përket rrjetit janë të ruajtura në GIS, si materiali, diametri, viti i instalimit, defektet, pusetat, ujëmatësit, valvulat, hidrantët etj. Baza e të dhënave e GIS-it është në SQL Server dhe është plotësisht e ndërlidhur edhe me bazat e të dhënave të Faturimit, Depos dhe CRM.

## 8. Departamenti i kualitetit të ujit

Kompania ka për obligim që qytetarëve të ju ofrojë ujë në cilësi dhe në sasi. Duke e parë rëndësinë e ujit që uji të jetë sa më kualitativ kompania gjithë herë e ka parë të arsyeshme që cilësia e ujit të jetë prioritet për qytetarët e zonës së mbulueshmerisë.

Laboratori i ujit ka kryer analiza edhe më herët, por që të jemi më të sigurtë në rezultate të analizave, ne si kompani kemi pasur kontratë me Institutin Rajonal të Shëndetit Publik në Pejë, të cilët kanë marrë mostrat në terren dhe kanë kryer analizat fiziko kimike dhe bakteriologjike për mostra. Instituti në fillim të muajit ka sjellë rezultatet për muajin paraprak.

Kjo rutinë e mostrimit ka zgjatur deri me 30.06.2024 kur laboratorit i kompanisë është akredituar. Pavarësisht nga akreditimi bashkëpunimi me Institutin do të jetë i përhershëm ku dhe mund të bëjmë krahasimin e rezultateve të mostrave të marra në pikën e njëjtë të mostrimit.

Për akreditim të laboratorit kemi filluar edhe më herët me blerjen e pajisjeve, ndarjen e hapësirës për laboratorin mikrobiologjik, ndërsa hapësira për laboratorin fiziko kimik ka qenë më herët e përcaktuar.

**\*Shënim:** varësisht nga vendi se ku merret mostra mund të kërkohej 1-2 orë deri në sjelljen e mostrave në laborator. Për kryerjen e analizave **fiziko-kimike** të ujit kërkohej së paku 2 orë, ndërsa për kryerjen e analizave **bakteriologjike** kërkohej 1-2 orë e pastaj 42-78 orë deri tek marrja e rezultateve.

Testohen këta parametra bakteriologjik:

|                                                      |
|------------------------------------------------------|
| Numri i përgjithshëm i baktereve koliforme në 100 ml |
| Bakteret koloiforme me prejardhje fekale në 100 ml   |
| Numri i përgjithshëm i baktereve të gjalla në 1 ml   |

Dhe këta parametra fiziko kimik:

|                                   |
|-----------------------------------|
| Turbullira                        |
| Vlera pH                          |
| Përcjellshmëria elektrike         |
| Kloruret                          |
| Fortësia e ujit                   |
| Kalciumi - Ca                     |
| Klori rezidual                    |
| Hekuri Fe                         |
| Mangani-Mn                        |
| Nitritet N-NO <sub>2</sub>        |
| Nitratet N-NO <sub>3</sub>        |
| Amoniaku N- NH <sub>3</sub>       |
| Harxhimi i KmnO <sub>4</sub> mg/l |
| Fosfatet PO <sub>4</sub> -P       |
| Marrja e mostrës                  |

Janë plotësuar me sukses jo konformitetet e gjetura për laborator brenda afateve të caktuara sipas raporteve nga DAK-u. Laboratorit të mikrobiologjisë i është bërë ndarja për testime dhe pjesa për pastrim, përgatitje të bazave ushqyese, sterilizim dhe inkubim.

## 9. Departamenti Komercial

Departamenti Komercial do të vazhdojë me rritjen dhe përmirësimin e aktiviteteve për të sjellë rezultate edhe për vitin 2026. Si bazë e këtij procesi do të jetë:

- Investimi/Blerja e printerëve/pajisjeve për lexim të ujëmatësve dhe faturim në kohë reale. 60copë
- Investimi/Blerja e telefonave të rinj dhe me performancë për të gjithë lexuesit. 60copë
- Riorganizimi i brendshëm dhe ndarja e detyrave konkrete për personelin e Departamentit.
- Përmirësimi, pasurimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave.
- Funksionalizimi i trezorit të qarkullimit për nevoja operative të të gjitha arkave në Pejë.
- Furnizimi me ujëmatës të mençur për konsumatorët komercialë me konsum të lartë, fokus: Autolarjet.
- Dërgimi i vërejtjeve përmes postës për konsumatorë.
- Shtypja dhe shpërndarja në kohë e faturave.
- Arkëtimi i borxhit të tanishëm dhe të vjetër përmes rrugëve ligjore (përmbarues dhe çkyçje).
- Përmirësimi i marrëdhënieve me konsumatorët përmes komisionit për shqyrtimin e ankesave.
- Komunikimi me konsumatorët përmes kanaleve të shumta të komunikimit telefonik dhe elektronik.

Aktivitetet më konkrete të cilat do të ndërmerren gjatë periudhës planifikuese për përmirësimin e vazhdueshëm të Departamentit Komercial do të jenë:

### 1.1 Investimi/Blerja e printerëve dhe telefonave të rinj

Gjatë vitit 2025 kemi filluar pilot-projektin për lexim dhe faturim në kohë reale. Ky projekt do të përmirësojë dhe lehtësojë procesin e faturimit, duke siguruar saktësi më të madhe dhe transparencë ndaj konsumatorëve.

Në fazën e ardhshme, projekti do të zgjerohet në të gjithë kompaninë dhe do të shoqërohet me investime në telefona të rinj me performancë më të lartë, të dedikuar për procesin e faturimit. Këto pajisje do të mundësojnë përdorimin e GPS-it për gjurmim më të saktë të leximeve dhe do të kontribuojnë në përmirësimin e efikasitetit të faturimit, si dhe në zvogëlimin e rasteve të faturimit informal.

- Projekti për printerë: 60 printerë
- Projekti për telefona: 60 telefona

### 1.2 Përditësimi i bazës së të dhënave

Gjatë vitit 2026, kompania planifikon të instalojë ujëmatës të mençur përveç furnizimit me ujëmatës të zakonshëm, tek të cilët bëhet ndalja e ujit dhe leximi nga distanca. Instalimi planifikohet të bëhet tek:

- Konsumatorët institucionalë
- Bizneset me përdorim mesatar dhe të lartë
- Konsumatorët me ujëmatës jo-funksional
- Të gjithë ujëmatësit e rinj do të jenë në përputhje me standardet e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë / Agjencisë së Metrologjisë dhe rekomandimeve të konsulencës.

### 1.3 Instalimi i ujëmatësve

Gjatë vitit 2026, kompania planifikon të instalojë ujëmatës të mençur përveç furnizimit me ujëmatës të zakonshëm, tek të cilët bëhet ndalja e ujit dhe leximi nga distanca. Instalimi planifikohet të bëhet tek:

- Konsumatorët institucionalë
- Bizneset me përdorim mesatar dhe të lartë
- Konsumatorët me ujëmatës jo-funksional
- Projektet e reja
- Të gjithë ujëmatësit e rinj do të jenë në përputhje me standardet e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë / Agjencisë së Metrologjisë dhe rekomandimeve të konsulencës.

#### **1.4 Saktësia e leximit të ujëmatësve**

Gjatë periudhës planifikuese 2026, kompania do të fokusohet në ngritjen e saktësisë së leximit duke riorganizuar lexuesit dhe ekipet e kontrollit. Lexuesit e ujëmatësve do të obligohen të bëjnë leximet sipas procedurave të brendshme të kompanisë.

- Ekipet e kontrollit do të aktivizohen gjatë gjithë gjashtëmuorit të parë, me orare mujore të ndara për të kontrolluar saktësinë e leximeve dhe probleme të tjera.
- Bazuar në ligjet në fuqi dhe rregulloret e ARRU-së, deri në fund të vitit 2026, të gjithë ujëmatësit do të rehabilitohen.
- Blerja e një programi për lexuesit me raportim online dhe raporte ditore për leximet, ku përcaktohen edhe normat/objektivat nga Drejtori Komercial.

### **9.1 Faturimi**

Faturimi do të kryhet sipas procedurave të brendshme, duke u bazuar në lexim (aty ku ujëmatësit janë funksionalë), në vlerësim (aty ku ujëmatësit janë përkohësisht jashtë funksionit) ose kur nuk ka fare ujëmatës.

Rritja e vlerës së faturimit pritet të vijë si pasojë e:

- Rritjes së numrit të konsumatorëve
- Leximit më të saktë të ujëmatësve
- Instalimit të ujëmatësve të rinj
- Aktivizimit të konsumatorëve pasivë
- Legalizimit të kyçjeve ilegale

Blerja e faturave me kontratë kornizë sipas nevojave për konsumator

Në vitin 2026, faturimi do të realizohet edhe me pajisje printimi që sjellin lehtësim, transparencë dhe saktësi.

### **9.2 Arkëtimi dhe inkasimi**

